

RREGULLORE PER PERDORIMIN E MARKES SE ÇERTIFIKIMIT

STATUSI I DOKUMENTIT

KOPJE E KONTROLLUAR NR.



KOPJE E PAKONTROLLUAR



Bot.	Rev.	Data	Pershkrimi	Hartoi (PSC) Dott. A. Shahu	Ripare (DT) Dott. A. Trapanà	Miratar (DP) Ing. S.Russo
1 [^]	00	01.06.2015	Botimi i pare			
1 [^]	01	01.09.2016	Rishikim ISO 17021-1:2015 schema ISO 27001			
1 [^]	02	02.07.2018	Zgjerimi i akreditimit me skemat ISO 9001- ISO 14001 ISO 45001- OHSAS 18001			
1 [^]	03	01.06.2020	Modifikim PSC- Pikat dhe seksionet			

INDEKSI

REFERENCA T DHE PERKUFIZIMET	3
1. TE PERGJITHSHME.....	3
2. MENYRA TE PERDORIMIT TE MARKES SE ÇERTIFIKIMIT	5
3. PERMASAT DHE NGJYRAT	5
4. ANULLIMI DHE PEZULLIMI I ÇERTIFIKIMIT	6
5.DETYRIMI KONTRAKTUAL	6
6. ANKESAT, REKURSET, APELET DHE MOSMARRVESHJET	6

REFERENCA T DHE PERKUFIZIMET

Dokumenti i referimit: **RG – 01** Rregullorja e Çertifikimit ne versionin e zbatueshem (ne fuqi)

Ne kete Rregullore jane ne perdorim perkufizimet qe vijojne:

Logo

Simboli i rregjistruar i Organizmit te Çertifikimit **LEGAL CERT shpk** per prezantimin e tij. Vetem Solo Organizmi i Çertifikimit mund te perdore logon e tij mbi dokumentat.

Marka

Eshte simbol qe **LEGAL CERT shpk** i jep klienteve te vet te çertifikuar dhe qe perdoret prej tyre per te treguar statusin e tyre te çertifikimit.

Perbehet nga:

- logo **LEGAL CERT shpk** se bashku me ikonon (ose referimin letrar)te Entit unik te akreditimit (DPA), per aktivitetet e mbuluara nga akreditimi;
- logo **LEGAL CERT shpk** per aktivitetet e pa mbuluara nga akreditimi;

LEGAL CERT shpk informon klientet e vet per kuptimit dhe te rendesise qe paraqesin Marreveshjet e Njohjes Reciproke (MLA) ndermjet Enteve te Akreditimit, si ne nivel europian dhe boteror, te cilet kontribojne per ti dhene vlere autoritare çertifikimeve te akredituara dhe favorizojne besimin, ne tregun nderkombetar, te cilesise se produkteve dhe sherbimeve te ofruara nga Klientet.

Objektivi i kesaj rregulloreje eshte te paraqese drejtimet e duhura per nje perdorim korrekt dhe koherent te markes se çertifikimit **LEGAL CERT shpk** si dhe te markes se Entit unik te Akreditimit (DPA) ne konformitet me Rregulloren perkatese ne fuqi.

Subjekti i çertifikuar nga **LEGAL CERT shpk** ne skemen e akredituar, nuk do te mundet te perdore Marken e akreditimit veçmas nga Marka e çertifikimit te Organizmit te Çertifikimit te akredituar.

Marka e DPA nuk do te perdoret ne menyre qe te nenkuptohet qe DPA te kete çertifikuar ose miratuar sistemin e menaxhimit te subjektit, ose produktin, ose personelin e nje mbajtesi te çertifikimit te akredituar, ose ne nje menyre tjeter mashtruese.

1. TE PERGJITHSHME

- 1.1 Kjo Rregullore permban udhezimet per realizimin e markes se çertifikimit **LEGAL CERT shpk**, i leshuar per subjektet qe kane marre çertifikimin, per perdorimin e tyre (ne materiale publicitar, kancelari, artikuj promociuale, mjete dhe ambjente te subjektit) dhe per publikimin ne faqen ne internet te subjektit.
- 1.2 Marka e çertifikimit dhe mjetet e suportit jane ne pronesi te **LEGAL CERT shpk** dhe i jepen ne perdorim subjekteve te çertifikuara. Lejohet perdorimi i markes se **DPA**, se bashku me ate te **LEGAL CERT shpk**, ne letra zyrtare dhe dokumenta te pergjithshem (me perjashtim te çdo dokumentacioni teknik ne lidhje me produkte te realizuara) ose mbi mjete te perdorura per realizimin e proceseve te perfshire ne sistemin e menaxhimit te çertifikuar (si mjetet komerciale, ndertesat, si dhe veshjet dhe uniformat e punes dhe te ngjashme) me perjashtim te objekteve qe konceptohen si produkte qe jane objekt i nje çertifikimi specifik, sidomos nese eshte e detyrueshme dhe e rregulluar (makineri, vegla pune, pajisje per mbrojtjen personale etj.)

Per perdorimin mbi mallra dhe mjete strumentale, kombinimi i dy Markave duhet te kompletohet me shtimin e nje fjalie te tipit “Subjekt me sistem te menaxhimit te çertifikuar, duke treguar Standardin e referimit te sistemit te çertifikuar (p.sh. UNI EN ISO 27001, ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001, ecc.)”.

Ne asnje rast nuk lejohet perdorimi i markes **DPA**, dhe as i markes **LEGAL CERT shpk**, dhe as ne menyre te kombinuar, ne asnje lloj dokumentacioni teknik qe mund te identifikojne ne ndonje menyre produktin, ne rastin kur Subjekti ka ne posedim nje Sistem te menaxhimit te çertifikuar.

- 1.3** **LEGAL CERT shpk** rezervon te drejten per te ndryshuar ne çdo moment marken e çertifikimit pas miratimit te Standardeve dhe/ose rregulloreve te reja, pas kerkesave te Entit unik te akreditimit (DPA). **LEGAL CERT shpk** njofton subjektet afatin brenda te cilit eshte parashikuar qe te pershtasin me rregullat e reja te gjithe dukumentacionin mbi te cilin jane vendosur markat.
- 1.4** Mjetet mbeshtetese per realizimin e markave jepen nga **LEGAL CERT shpk** falas. Nuk mund te prodhohen marka çertifikimi qe nuk rrjedhin nga mjetet mbeshtetese te dhena zyrtarisht nga **LEGAL CERT shpk**.
- 1.5** Subjektet qe deshirojne te perdorin marken jane te detyruara te zbatojne ate qe eshte parashikuar ne kete rregullore.
- 1.6** Perdorimi jo sipas kesaj rregullore e markes se çertifikimit mund te klasifikohet si Mos Konformitet nga ana e **LEGAL CERT shpk** dhe, ne rastin kur zbulohet, subjekti angazhohet per nderprerjen menjehere te perdorimit te pa rregullt te markes se çertifikimit.
- 1.7** Çertifikimi dhe botimi i tij jane te rezervuara per Subjektin e çertifikuar dhe jane te pa transferueshme.
- 1.8** Marka e çertifikimit duhet te jete e shoqeruar gjithmone nga marka dhe/ose emri i Subjektit sipas rregullave qe vijojne:
- Marka nuk mund te publikohet ne dokumente qe perfshijne pjese te strukture te pa çertifikuara;
 - Marka e çertifikimit nuk mund te perdoret kur çertifikimi nuk eshte leshuar ende ose eshte revokuar, pezulluar ose kur subjekti ka hequr dore prej tij;
 - Marka e çertifikimit nuk duhet te perdoret ne rastet kur mund te shkaktoje ngaterrim midis çertifikimit te sistemit te menaxhimit dhe çertifikimin e produkteve/sherbimeve te zhvilluara nga subjekti;
 - Marka e çertifikimit dhe marka DPA (ne menyre te kombinuar dhe jo) nuk duhet te riprodhohen mbi produkte, ambalazhime primare dhe sekondare, mbi dokumentacione teknike dhe pershkruese te produkteve, mbi çertifikata laboratorike, ne raporte, ne shirita ngjites, ne raporte auditimi, kalibrimi etj.;
 - Subjektet qe marrin çertifikimet brenda sektoreve/skemave te akreditimit **LEGAL CERT shpk** mund te perdorin marken ne versionet e parashikuara ne Nenin 3 ne vijim;
 - Subjektet qe marrin nga **LEGAL CERT shpk** çertifikime te nje skeme te akredituar nuk mund te perdorin marken e **DPA** te ndare nga marka e çertifikimit te Organizmit te Çertifikimit;
 - Subjektet qe marrin nga **LEGAL CERT shpk** çertifikime te nje skeme te akredituar nuk mund te perdorin marken e **DPA** ne menyre qe te nenkuptohet qe DPA ka çertifikuar ose miratuar sistemin e menaxhimit te subjektit, ose produktin ose personelin te nje mbajtesi te çertifikimit te akredituar, ose ne nje menyre tejter mashtruese;
- 1.9** Ne rastet kur eshte e mundur duhet te shprehet qartesisht qe çertifikimi i sistemit te menaxhimit eshte e limitar per vendin/et, dhe/ose ndertesën/at, produktit/eve, te percaktuar/ara ne çertifikate.
- 1.10** Subjekti duhet te korigjojte te gjitha materialet reklamuese ne rastin kur fusha e zbatimit te çertifikimit eshte reduktuar dhe/ose ndryshuar; nuk duhet te leje te kuptohet qe çertifikimi aplikohet per aktivite qe jane

jashte fushes se zbatimit certifikimit.

- 1.11** Ne rastin kur **LEGAL CERT shpk** i revokohet ose i hiqet akreditimi ne nje skeme te percaktuar, subjektet e licensuara per perdorimin e markes se saj te certifikimit, duhet te ndalojne referimin tek marka e DPA se bashku me marken **LEGAL CERT shpk** ne te gjitha format dhe vendet e lejuara nga kjo Rregullore (produkte, konfeksione, ambalazhe, pasuri te luajteshme dhe paluajteshme, zarfe, dokumentacion teknik, komercial, reklamues etj.).

2. MENYRA TE PERDORIMIT TE MARKES SE ÇERTIFIKIMIT


2.1 Meposhte jane disa parashikime per perdorimin e markes se certifikimit te ndryshueshme ne varesi te mjetit ku vendoset:

- Letra per shkresa, zarfe, fatura, kartvizita, material reklamues, artikuj promocional, dhe material tjeter kancelarie: ne keto raste marka e certifikimit duhet te vendoset prane markes ose emrit te subjektit; ne rastin kur nuk nuk eshte e mundur mund te perdoret vetem deklarata e parashikuar ne piken 3;
- Letra per shkresa, zarfe, fatura, kartvizita, material reklamues, artikuj promocional, dhe material tjeter kancelarie (konsorciume dhe shoqeri te lidhura): ne rastin kur certifikimi i leshohet nje konsorciumi shoqerish marka duhet te vendoset ekskluzivisht prane markes ose emrit te konsorciumit dhe ne asnje rast nuk duhet vendosur prane markes ose emrit te shoqerise se lidhur. Ne rastin kur certifikimi i leshohet nje subjekti te lidhur pjese e nje konsorciumi marka e certifikimit duhet te vendoset vetem prane markes ose emrit te subjektit te certifikuar ne menyre qe mos lindin dyshime mbi pronesine e certifikimit;
- Publikimi ne internet: vlen çfare eshte parashikuar me pare;
- Mallrat kapitale te subjektit: eshte i lejuar perdorimi i markes se certifikimit mbi mallra, mjete dhe vegla qe perdoren per realizimin e proceseve qe hyjne ne fushen e sistemit te menaxhimit te certifikuar (makina, ndertesa, tutat e punes, veshje, tabelat e kantierit) me perjashtim te objekteve qe konceptohen si produkte objekt i nje certifikimi specifik. Marka e certifikimit duhet te vendoset prane markes se subjektit dhe duhet te proporcionohet ne dimensione me te.

3. PERMASAT DHE NGJYRAT

- 3.1** Permasat e Markes se certifikimit duhet te jene ne proporcion me permasat e markes se subjektit ne afersi te te ciles do te vendoset.
- 3.2** Permasat e markes mund te zvogelohen ose te zmadhohen duke mbajtur te pandryshuar proporcionet. Duhet te garantohet gjithmone lexueshmeria e fjaleve dhe numrave.
- 3.3** Permasat minimale te riprodhimit te markes jane ne lidhje te ngushte me lexueshmerine e te gjithe informacioneve te permbajtura ne te.
- 3.4** Permasat maksimale duhet te jene te tilla qe mos jene me te medha se permasat e markes se subjektit.
- 3.5** Jane parashikuar mundesi te ndryshme ne menyre qe subjektet, sipas deshires, te mund te mbajne versionin me te pershtatshme per nevojat e tyre, me konkretisht:

Imazh i markave te certifikimit per perdorim

	Rregullore per perdorimin e Markes se Çertifikimit	REG - 02		
		Bot. 1^	Rev. 03	01.06.2020

Leter dhe dokumente shkresore



- 3.6** Ne rast se per arsye grafike, hapesire ose per zgjedhje te lire, subjekti nuk do mund te perdore marken e çertifikimit por deshiron t'u provoje te treteve çertifikimin, duhet te perdore, me te njejtat menyra te parashikuara ne kete rregullore, deklaraten e meposhteme:

“Subjekt me Sistemin e menaxhimit per cilesine ISO (te specifikohet standardi referues: ISO 27001 - ISO 9001 – ISO 14001 – ISO 45001) i çertifikuar nga **LEGAL CERT shpk**.

Çertifikimi i referohet veprimtarive dhe selive te parashikuara ne çertifikaten n. “.

4. ANULLIMI DHE PEZULLIMI I ÇERTIFIKIMIT

Ne rastet e revokimit, heqjes, heqjes dore, skualifikimit dhe gjate periudhes se pezullimit te çertifikimit, subjekti duhet te ndaloje menjhere perdorimin e markave te çertifikimit dhe/ose te deklarates se çertifikimit ne çdo dokument ose suport ne te cilin ato jane vendosur.

5. DETYRIMI KONTRAKTUAL

Konformiteti i subjekteve me kete rregullore perben nje detyrim kontraktual siç parashikohet nga **REG 01** “Rregullore per Çertifikimin e Sistemeve te Menaxhimit”.

6. ANKESAT, REKURSET, APELET DHE MOSMARRVESHJET

Ne lidhje me kete aspekt vlen çfare eshte parashikuar ne REG 01 “Rregullore per Çertifikimin e Sistemeve te Menaxhimit”.